



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE Durrës

NOTER ARIF KAJNOZI
ADRESA Rruga Selvija Numer 3, Sukth
i Ri 2010, Sukth, Durres
TEL: 0682952394

VËRTETIM I NËNSHKRIMIT NË AKTET E SHOQËRIVE TREGTARE

Nr. repertori: 1004

Sukth më 26/02/2025

Arif
Kajnozi

Firmosur elektronikisht nga
NISA me certifikaten Arif
Kajnozi
Data: 2025.02.26
12:47:35+01:00

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar



V2025014090046232398

STATUT DHE AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
“ KAZANI GROUP ” shpk.

Kreu I

Themelimi Statusit dhe Aktit te Themelimit, Emri,Objekti,Kohezgjatja,Selia dhe Adresa e Faqes se Internetit

Neni 1

Data e themelimit,Emri dhe Themeluesit

Sot me date 26.02.2025 (dymije e njezete e pese) dite e merktire, unë themeluesi, **Andi Kazani**, atësia Sabedin, amësia Fatbardha, shtetas Shqiptar, lindur në Gjuras, Dibër dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Besa; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 8; Njesia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 02/04/1997, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike me nr. personal J70402066N.

Shoqeria “ **KAZANI GROUP** ” shpk, zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me Aktin e Themelimit e Statutin e saj.

Themeluesi ne kete sipermarrje ka derdhur kapitalin e tij me qellim qe te perfitojë te ardhura qe mund te vijne nga ushtrimi i veprimtarise private si dhe te perballojë humbjet deri ne kufirin e vleres se derdhur ne kapitalin themeltar.

Neni 2

OBJEKTI

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqerise do te jetë:

a) në fushën e tregtisë, në drejtimit ushqimore të mëposhtme:

- Importi i vajrave te ullirit dhe vegjetal
- Eksporti i tyre jashte territorit te Republikes se Shqiperise
- Ambalazhimi, konsulenca per perdorimin e produktit dhe krijimi i recetave
- Përpunimi dhe ndryshimi i produktit bazë.
- Certifikimi dhe cilesia e produktit “Oksitester”.
- Krijimi i barkodeve
- Krijimi i brendeve te ndryshme
- Perpunimi i ullinjve nga faza fillestare
- import-eksport,tregtimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve,me shumice e pakice,
- tregtimin e artikujve te ndryshem industriale,
- tregtimin e artikujve te ndryshem ushqimore,
- tregtimin e artikujve te ndryshem bujqesore e blegtoral,
- tregtim fruta-perime,
- tregtim pajisjesh elektro-shtepiake,elektronike,higjiemo-sanitare,hidraulike,prodhime qeramike,artizanati etj,
- tregtim bimesh mjekesore e eterovajore, plehra kimike, pesticide, konfeksione e tekstile, artikuj kozmetike e farmaceutike,kepuce te cdo lloji,galanteri dhe artikuj lekure,
- tregtim pijesh alkoolike dhe jo alkoolike,
- hapje autoshkolle,

- hapje pike lavazhdi dhe servisi per automjete,
- tregtim me pakice e shumice te karburanteve.

b) në fushën e ndërtimit,në kategoritë e mëposhtme:

- tregtim automjetesh te çdo lloji,marke e tonazhi si dhe tregtimin e pjeseve te kembimit per to,dhenie me qira,
- punime gërmimi në tokë,
- ndërtime civile dhe industriale,
- rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasadash,
- rruge,autostrada,mbikalime,hekurudha,tramvai,metro,pista aeroportual,
- ujesjellesa,gazsjellesa,vajsjellesa,vepra kullimi e vaditje,
- ndertime per n/stacione,kabinat e transformatoreve,linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise,
- punime per prishjen e ndertimeve,
- impiante hidrosanitare,kuzhina,lavanteri,mirembajtja e tyre,
- impiante ngritese dhe transportues(ashensore,shkalle levizese,transportues),
- punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to,rifiniture me materiale druri, plastic, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese,
- impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut,
- sinjalistika rrugore jo ndricuese,
- barriera dhe mbrojtje rrugore,
- ndertime parafabrikat beton arme,struktura metalike dhe druri,
- impiante teknologjike,termike dhe te kondicionimit,
- impiante dhe linja telefonie e telekomunikacioni,
- Impiante te brendshme,elektrike,telefoni,radiotelefoni,TV etj,
- punime topogjeodezike,
- punime nentokesore,ura e vepra arti,
- diga dhe tunele hidroteknike,
- ndertime detare dhe punime thellimi ne uje,
- punime dhe mbrojtje lumore,sistemime hidraulike dhe bonifikime,
- ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise elektrike,
- punime te inxhinierise se mjedisit,
- punime strukture speciale,
- shtresa dhe mbistruktura speciale,
- punime mbi shina dhe traversa,
- pastrimi i ujrave detare,liqenore dhe lumore,
- ndertimi i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij,
- ndertimi i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane,
- sistemet kundra zhurmes ne infrastrukture,
- shpime gjeologjiko-inxhinierike,puse e shpime per uje.

c)në fushën e transportit,në drejtimet e mëposhtme:

- transport mallrash te te gjitha llojeve brenda e jashte vendit,
- transport pasagjeresh brenda e jashte vendit,
- transport materialesh ndertimi e lende te para brenda e jashte vendit.

d)në fushën e shfrytëzimit minerar,punimeve të ndryshme dhe përmirësimit mjedisor,në drejtimet e mëposhtme:

- aktivitet minerar ne nxjerrje,perpunim e pasurim te mineralit te kromit,te ferrokromit si dhe tregtim e eksportim te tyre,transport dhe ndërmjetësim per tregje te mineralit te kromit,prodhim koncentradi,
- shpime nentokesore,
- shfrytezim mineralesh te ndryshme,
- hapje e shfrytezim hotelesh,motelesh,baresh,restorantesh,diskotekash,qendra pushimi e kurative,
- punime duralumini e tregtimi i tyre,
- punime druri,tregtim prodhimesh te ndryshme druri:mobilje,oriendi,dyer,dritare etj,
- permitiesimi i pyjeve,shfrytezimi,perpunimi dhe tregtimi i lendes drusore,mbrojtja dhe permitiesimi i livadheve e kullotave,mbrojtjen e pyjeve nga zjarri e demtuesit, permitiesimin e flores e faunes se zonave,
- veprimtari ne studim,projektim dhe zbatim punimesh ne fushen e pyllzimit dhe permitiesimit pyjor,mbareshtim pyjesh,mbareshtim i faunes,mbareshtim i flores, mbareshtim i kullotave dhe livadheve,ndertim dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota e livadhe,
- punime te ndryshme alumini,llamarine,punime ulluqesh etj si dhe tregtimi i tyre,
- punime hekuri,lyerje dhe tregtimi i tyre,
- shtrime pllakash,lyerje ndertesash,
- tregtim i te gjithë produkteve te hekurit,aluminit dhe llamarines,
- Ruajtje dhe sigurim i objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike e juridike qe ushtrojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise,**
- Sigurimi,mbrojtja e jetes dhe e shendetit te shtetasve vendas dhe te huaj.**

Neni3

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqeria tregtare “ **KAZANI GROUP** ” **shpk**, do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike me nje kufi te pacaktuar mbi 15 vjet dhe mund te shpërbëhet në cdo kohe per çfarëdo shkak.

Neni 4

Selia,Adresa e Faqes se Internetit dhe Adresa Elektronike

Shoqeria “ **KAZANI GROUP** ” **shpk**, e ka seline e saj ne Njësia Administrative Xhafzotaj Durrës, në pasurinë me numë 158/331/ND, vol 22, faqe 186 , në zonën kadastrale 2574.

Adresa e faqes se internetit te shoqerise eshte: info@itaworld.eu

Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik: info@itaworld.eu

Ajo ka te drejte te krijojë brenda dhe jashte territorit te Republikës se Shqiperise, dege,filiale,agjensi përfaqesimi si dhe ti suprimojë ato.

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njësi grumbulluese, përpunuese, shërbimi e tregtimi,duke bashkepunuar me persona fizike e juridike, vendas ose te huaj.

Kreu II KAPITALI I REGJISTRUAR I SHOQERISË

Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

Kapitali fillestar themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqind mijë)leke i përbërë nga kuotat e Ortakut themelues. Kapitali themeltar i shoqërisë është i formuar tërësisht nga kontributi i barabartë në masën 100% i Ortakut Themelues.

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tij të mëposhtme:

1.Ortaku themelues Andi Kazani:

-kontribut në para

-vlera e kontributit: 100.000 (njqind mijë)leke

-kuota e zotimit të kapitalit të shoqërisë është 100%.

Vlera totale e kapitalit të regjistruar është: 100.000 (njqind mijë)

Vlera e paguar: 100.000 (njqind mijë).

Kontributet në para do të paguhet plotësisht menjëherë.

Kontributet në natyrë do të kalojnë shoqërisë menjëherë pas regjistrimit në QKR.

Pagesat e kontributeve në para do të kryhen në llogarinë bankare pranë Bankes Credins Bank, Dega Shkozë Durrës.

Pjesët e kapitalit themelor janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkeshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve. Te gjitha pjesët e kapitalit të shoqërisë mund të kalojnë, tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në ortakëri, por gjithmone me Vendim të Asamblesë së Ortakëve dhe me akt notarial.

Trashëgimtari hyn në shoqëri me të gjitha të drejtat e Ortakut dhe për të gjitha efektet juridike.

Kapitali i shoqërisë përbehet nga kapitali themeltar dhe të ardhura të tjera të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë tregtare. Te gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga Ortaku themelues i shoqërisë.

Kapitali themeltar prej 100.000 (njqind mijë) lekë ndahet në 1 kuotë të Ortaku themelues Andi Kazani është zotues i 100% i kësaj kuote, në këtë mënyrë Andi Kazani zoteron 100% të nënshkruara e të paguara.

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të administrohet nga Ortaku themelues. Një pjesë e këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqëria është e detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

Neni 6

Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara

1.Administratori mund të kërkojë ortakut të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tij dhe ortakut (pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me kështu të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij

pavarësisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

2. Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaje një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.

3. Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratori mund të njoftojnë paraprakisht të paktën katërmëdhjetë Ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumën e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarin se në rast moszbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.

4. Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorit dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumën e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

5. Në pajtim me dispozitat ligjore, Administratori i konsideron të përshtatshme të gjitha veprimet që kryen vetë.

Neni 7

Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së ortakëve, në përputhje me parashikimet e Nenit 87 të Ligjit 9901.

Neni 8

Çertifikatat e kuotave

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat ezotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 9

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3.Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Neni 10

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

1.Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakut.

2.Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

Neni 11

Blerja e Kuotave të Veta

1.Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do ti shpërndahen ortakut apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen.

Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit “Per tregtarët dhe shoqëritet tregtare”.

Kreu III

Asambleja e Përgjithshme

Neni 12

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

1.Administratori thërret Asamblenë e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakut sipas Nenit 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.

2.Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*email*) drejtuar ortakut, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 dite përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Ortakut, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.

3.Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortaku është dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 13

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

1.Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortaku ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortaku nëse merr pjesë me mjete komunikimi elektronik ka të drejtë të votojë nëpërmjet numrit PIN që i është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

2.Administratori cakton Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e tij.

3.Nëse Administratori nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

4.Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

5.Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.

6.Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:

7.Me përjashtim të kundërshtimit të një ortaku, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

8.Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Transferimi i shoqërisë nga një formë në një tjetër bëhet me vendim të Ortakut ,kur plotësohen kushtet për krijimin e shoqërive të llojeve të tjera.

Neni 14

Vota e Ortakut

Organ vendimor janë:

-Vendimet e Asamblese se Ortakut.

Asambleja e Ortakut vendos për çështje të tilla si shkarkimin e eksperteve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimin e raporteve të administrimit dhe kontrollon miratimin e llogarive, ndryshimet në statut, zvogelimin e kapitalit themeltar ose zmadhimin e tij, transferimin e pjesve të kapitalit themeltar tek të tretet, kryerjen e veprimtarisë për likuidimin e shoqërisë, shndërrimin e shoqërisë në një formë tjetër të parashikuar nga ligji, ndryshimi i selisë së shoqërisë etj.

Asambleja e Ortakut i bën mbledhjet e zakonshme çdo vit brenda katër muajve nga mbyllja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë.

1. Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

2.Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

Neni 15

Votimi me Prokurë

1. Përfaqësuesi do të emërohet nga ortakut në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratori.

2. Aktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratori depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

3. Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*) sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 16

Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

(2) Kur ortakut përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakut, të cilin përfaqëson.

Neni 17

Hetimet e posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

Administratorët

Neni 18

Emërimi i Administratorëve

Administrator i shoqërisë do të jetë z. Andi Kazani

-Administratori qendron në detyrë për një periudhë pesëvjeçare, me të drejtë ripërtëritje, duke filluar afatin e qëndrimit në detyrë që me datën 26.02.2025 deri me datën 25.02.2040.

-Mandati i tij mund të jetë i rinovueshem. Asambleja e Ortakut gezon të drejtën që në çdo kohë të shkarkojë nga detyra administratorin dhe të emerojë një tjetër në vend të tij.

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2. Administratori i një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohet si administrator i një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Administratori do të caktohet si Kryetar i mbledhjeve deri në zgjedhjen nga mbledhja e parë e zakonshme.

Neni 19

Kompetencat e Administratorëve

Administratori ka të drejtë e detyrohen të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatis dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të therrasë Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 20

Perfaqësimi

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit 9901.

2. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tij njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

3. Administratori mund t'ia delegojë kompetencat e tij çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë Administratorë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosi Administratori dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratori nuk mund të delegojë detyrimet e tyre ligjore.

Neni 21

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorëve

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;

2. personi ndodhet në gjendje paaftësie pagueuse;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorit, gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e Administratorit, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 22

Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit

1. Administratori shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e Nenit 97 të Ligjit "Per tregtare dhe shoqëritë tregtare".
2. Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.
3. Administratorit mund t'i paguhet të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Administratorit ose të komiteteve të Administratorit ose të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me përmbushjen e detyrave të tij.

Neni 23

Mbledhjet e Administratorit

1. Mbledhjet e Administratorit do të mbahet sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme cakton Administratorin me detyrën e Kryetarit të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo mbledhje të Administratorit në të cilat ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm Brenda pesë minutave nga ora e caktuar për mbledhjen, Administratori i pranishëm mund të emërojnë Kryetar të mbledhjes.
3. Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.
4. Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorit, ose nga një komitet i Administratorit, do të konsiderohen të vlefshme njëjloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si Administratorë dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

Neni 24

Kufizimet në Votimet e Administratorëve

1. Administratori nuk do të lidhë marrëveshje ose votojë për çështje, interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit 9901, deri në momentin kur në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë antari ka rënë dakord që:
 - të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe
 - të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.
 Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

2.Vota e Administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë. Dispozitat e nenit 89 të Ligjit "Per tregtatert dhe shoqerite tregtare" do të zbatohen lidhur me përjashtimin e Administratorit nga vendimet e marra në këtë mbledhje.

3.Në rast se në mbledhjen e Administratorit ose të komitetit të Administratorit diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një Administratori, çështja mund ti drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë.

Neni 25

Procesverbalet e Mbledhjeve të Administratorit

Administratorit kujdeset që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

1. të gjitha takimeve të kryera nga Administratori dhe

2.të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjeve të Administratorit dhe komiteve të Administratorit, përfshirë edhe emrin e Administratorit të pranishëm në këto mbledhje.

Kreu IV

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 26

Dividendët

1.Pas plotësimit të parashikimeve të Nenit 77 të Ligjit 9901, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakut.

2.Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhën në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhën në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

3.Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

4.Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 27

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit 9901, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE DHE REZERVA E DOMOSDOSHME

Neni 28

Cdo vit financiar fillon me 1 janar te cdo viti dhe perfundon me 31 dhjetor, me perjashtim te vitit te pare, ku si fillim eshte data e regjistrimit te shoqerise.

Neni 29

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori apo nga ekspertet kontabel miratohen nga Asambleja. Miratimi i dokumenteve financiare vjetore behet brenda nje afati 3 mujor te mbylljes se vitit financiar.

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe vertetimit te ekzistences se fitimit mund te krijoje dhe fonde te tjera.

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se sigurimeve shoqerore e shendetesore etj. Ajo ka te drejte te çelë llogari likujduese prane cdo banke brenda vendit dhe te kryeje veprime likuidimi me to.

MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT DHE LIDHJA E KONTRATAVE

Neni 30

Marredheniet e punesimit brenda Shoqerise rregullohen nepermjet kontrates se punesimit qe lidhet midis paleve ne perputhje me Ligjin nr.7961, date 12.07.1995 "Kodi i Punes ne Republiken e Shqiperise" si dhe legjislacionit tjeter shqiptar qe bën fjalë për punësimin.

Neni 31

Marrja ne pune behet me regjistrimin nga punedhenesi ne librin e punes se shoqerise si dhe duke njoftuar Organet kompetente ne fushen e punesimit te juridiksionit ku ushtron veprimtarine shoqeria.

Neni 32

Largimi nga puna behet me mbarimin e kontrates se punes ose perpara mbarimit te afatit te kontrates per shkelje disiplinore ose me vete kerkesen e punemarresit.

Largimi nga Shoqeria behet pasi jane shlyer te gjitha detyrimet materiale dhe monetare.

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti te shkruar te leshuar nga Ortaket themelues.

Neni 33

Shoqeria mund te lidhe kontrata me ente shteterore si dhe me persona fizike e juridike, vendas ose te huaj.

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga Administratori i saj ose nga nje person tjeter i autorizuar prej tij me prokure.

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine.

Kreu V

Prishja dhe njoftimet

Neni 34

Prishja dhe likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

d) me vendim të gjykatës;

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueese janë Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901.

Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi emerohen një ose disa likuidatore të cilët ndjekin operacionet e likuidimit deri në fund dhe i paraqesin Asamblese së Ortakeve dhe administratorit rezultatet përfundimtare të likuidimit. Në përfundim Asambleja e Ortakeve vendos për heqjen e mandatit të tyre. Të gjitha detyrimet që dalin nga likuidimi, Ortaket themelues marrin përsipër që ti shlyejnë me kapitalin e tyre.

Neni 34

Njoftimet

1. Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

2. Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit.

3. Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet).

Neni 36

Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, ato do të zgjidhen me rrugë gjyqësore në gjykatën kompetente.

Neni 37

Për çështjet e tjera që nuk janë trajtuar në këtë Statut, shoqëria do të referohet në çdo kohë Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe akteve të tjera ligjore e nenligjore në zbatim të tyre.

Neni 38

Ky Statut është hartuar dhe nënshkruar në Shkozë, Durrës, më 26.02.2025

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË

Andi Kazani

Andi Kazani

 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER ARIF KAJNOZI



V2025014090046232398

DATE 26/02/2025
NR REP 1004

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 26.02.2025, para meje Noterit ARIF KAJNOZI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Sukth, Rruga Selvija Numer 3, Sukth i Ri 2010, Sukth, Durres, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUESI:

Andi Kazani, atësia Sabedin, amësia Fatbardha, shtetas Shqiptar, lindur në Gjuras, Dibër dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Besa; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 8; Njesia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 02/04/1997, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike me nr. personal J70402066N.

Subjekti i mësipërm, me vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noterit, **"VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE "KAZANI GROUP" SHPK"**, bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "*Për Noterinë*", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave Personale*", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

ARIF KAJNOZI

